

VENDIM
Nr.13, datë 4.1.2012

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.854, DATË 17.12.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRITERET DHE MASËN E PËRFITIMIT TË PAGESËS SË
PAPUNËSISË PËR BASHKËSHORTIN/EN E USHTARAKUT AKTIV TË FORCAVE
TË ARMATOSURA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 37 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.854, datë 17.12.2004 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:
 - a) Pas shkronjës “d” të pikës 1 shtohet shkronja “dh”, me këtë përmbajtje:
dh) Bashkëshorti/ja ka paguar rregullisht kontributet për sigurimet shoqërore deri në momentin e përfitimit të pagesës së papunësisë.”.
 - b) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:
“1/1 Dokumentacioni që vërteton përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, përtërihet çdo vit nga vetë përfituesi dhe dorëzohet në strukturën ku përfiton këtë pagesë.”.
2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha